

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË

TRAJTIMIT EKONOMIK DHE FINANCIAR TË FAMILJARËVE TË

PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT QË HUMBIN JETËN PËR

SHKAK TË DETYRËS, DHE PUNONJËSVE QË PLAGOSEN DHE

DËMTOHEN GJATË OSE PËR SHKAK TË DETYRËS”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të trajtimit ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”, ka si qëllim përmirësimin e trajtimit ekonomik e financiar të familjarëve të punonjësve të policisë, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të detajuara për trajtimin financiar dhe ekonomik të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit, që humbin jetën për shkak të detyrës, punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës, trajtimin mjekësor të punonjësve dhe familjarëve të tyre, në institucionet mjekësore brenda dhe jashtë vendit, si dhe pagesën për shpenzime varrimi.

Aktet ligjore në fuqi që rregullojnë trajtimin financiar dhe ekonomik të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit, që humbin jetën për shkak të detyrës, parashikojnë përfitime të ndryshme. Për këtë qëllim, nëpërmjet këtij projektvendimi synohet të rregullohen përfundimisht diferencat e përfitimeve të deritanishme, që rrjedhin nga zbatimi i këtyre akteve ligjore, duke krijuar kështu mundësinë e një trajtimi sa më dinjitoz të këtyre familjeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti nuk është planifikuar në Programin Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2026, për MPB, por është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave në lidhje me përmirësimin e trajtimit ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë në koherencë me ndryshimet ligjore që solli ligji nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Ky projektvendim synohet të miratohet si detyrim nga miratimi i ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” dhe konkretisht në zbatim të pikës 2, të nenit 108, të pikës 2, të nenit 111, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi është hartuar në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga hyrja në fuqi e ligjit të ri të Policisë së Shtetit, ligji nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” dhe konkretisht në zbatim të pikës 2, të nenit 108, të pikës 2, të nenit 111, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si detyrim për të plotësuar ligjin me aktet nënligjore të tij.

Kuadri rregullator në fuqi që rregullon trajtimin financiar dhe ekonomik të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit, që humbin jetën për shkak të detyrës, parashikojnë përfitime të ndryshme.

Për këtë qëllim, nëpërmjet këtij projektvendimi dhe në zbatim të nenit 111, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, synohet të rregullohen përfundimisht diferencat e përfitimeve të deritanishme, që rrjedhin nga zbatimi i këtyre akteve ligjore e nënligjore, duke krijuar kështu mundësinë e një trajtimi sa më dinjitoz të këtyre familjeve.

Familjarët e punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, aktualisht trajtohen me aktet ligjore si më poshtë:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të trajtimit ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”

- Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”.
- Ligji nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 10 289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihmë të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”.

Në zbatim të akteve ligjore të sipërcituar, trajtimi i familjarëve të punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, ka përcaktime jo të njëjta në përfitime, nga këto familje.

Ky projektvendim zgjidh përfundimisht diferencat të cilat rrjedhin nga zbatimi i disa akteve ligjore, lidhur kjo me trajtimin ekonomik e financiar midis familjeve.

Në këtë projektakt parashikohet trajtimi me ndihmë financiare i familjeve të punonjësve të policisë që kanë humbur jetën nga viti 1990 deri më 31.12.1998, pasi këto familje nuk kanë qenë përfitues të vendimit nr. 552, datë 27.11.1999, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë, që humbin jetën ose plagosen për shkak të detyrës”, i cili i shtrinte efektet financiare nga data 1 Janar 1999 dhe në vazhdim.

Në këtë kontekst, për shkak të trajtimit të ndryshëm financiar midis familjarëve të dy periudhave të ndryshme (nga viti 1990 deri në 1 Janar 1999 dhe pas 1 Janarit 1999 e në vazhdim), ndonëse të përballur me të njëjta rrethana vështirësie shpirtërore, psikologjike, sociale dhe ekonomike, familjarët e punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës para datës 1 Janar 1999, kanë shprehur shqetësimin, zhgënjimin dhe indinjatën e tyre në mënyrë të

vazhdueshme mbi këtë trajtim të diferencuar, duke kërkuar trajtim financiar në mënyrë të barabartë me familjet që janë trajtuar pas kësaj date, 1 Janar 1999.

Kështu, në projektvendim, propozohet që pjesëtarët e familjes, që bashkëjetonin me punonjës in e policisë, në çastin e humbjes së jetës, për shkak të detyrës, për periudhën nga viti 1990 deri 31.12.1998, të përfitojnë ndihmë financiare, në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë. Kjo vlerë është e njëjtë me vlerën e përfituar nga familjarët sipas pikës 1, të vendimit nr. 552, datë 27.11.1999, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë, që humbin jetën ose plagosen për shkak të detyrës”.

Termi “jetonin”, në kuptim të këtij projektvendimi përfshin pjesëtarët e familjes sipas certifikatës familjare në kohën kur punonjësi i policisë ka humbur jetën.

Projektvendimi gjithashtu për këto familje, zgjidh problemin e strehimit, shkollimit dhe punësimit me përparësi të familjarëve të punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, sikurse përcaktohet në nenin 111, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Me këtë projektvendim trajtohen edhe rastet e plagosjes ose dëmtimit të shëndetit, gjatë ose për shkak të detyrës, të punonjës it të policisë, të cilët përfitojnë kompensim, i cili mbulohet nga buxheti i Policisë së Shtetit, sipas nenit 108, të ligjit 82/2025 “Për Policinë e Shtetit”. Edhe kjo kategori përfituesish aktualisht trajtohet, sipas vendimit nr. 552, datë 27.11.1999 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë, që humbin jetën ose plagosen për shkak të detyrës” dhe Udhëzimi i Përbashkët nr. 1192, dt. 08.03.2000 i Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Rendit Publik, “Për kriteret e mënyrat e trajtimt ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë që humbin jetën ose plagoseen në krye të detyrës”, të cilat do të shfuqizohen nga ky projektvendim.

Duke qenë se vendimi nr. 552, datë 27.11.1999 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë, që humbin jetën ose plagosen për shkak të detyrës” dhe Udhëzimi i Përbashkët nr. 1192, dt. 08.03.2000 i Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Rendit Publik, “Për kriteret e mënyrat e trajtimt ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë që humbin jetën ose plagosen në krye të

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të trajtimit ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”

detyrës” ka objekt edhe trajtimin ekonomik të personelit të Policisë së Shtetit dhe pjesëtarët e familjeve të tyre dhe këto akte bazohen në akte nënligjore të shfuqizuara, është vlerësuar përfshirja e këtij trajtimi në këtë projektvendim.

Nisur nga objekti dhe qëllimi i këtij projektvendimi është përfshirë edhe trajtimi financiar për shpenzime varrimi i familjes së punonjësit të policisë kur janë aktivë, me pagesë kalimtare, në pension pleqërie dhe studentë kursantë, sipas të nenit 7, të ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtim e të punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Republikën e Shqipërisë”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Baza ligjore e projektvendimit është neni 100 të Kushtetutës, pika 2, e nenit 108, pika 2, e nenit 111, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të trajtimit të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës”, është i përbërë nga trembëdhjetë krerë në të cilët përcaktohen:

Në **Kreun I**, përcaktohen dipozitat e përgjithshme, ku qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të detajuara për trajtimin financiar dhe ekonomik të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit, që humbin jetën

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të trajtimit ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”

për shkak të detyrës, punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës, trajtimi mjekësor i punonjësve dhe familjarëve të tyre, në institucionet mjekësore brenda dhe jashtë vendit, si dhe pagesën për shpenzime varrimi.

Në Kreun II, përcaktohen përfituesit e ndihmës së menjëhershme të cilët janë pjesëtarët e familjes, që bashkëjetonin me punonjësin e policisë në çastin e humbjes së jetës, për shkak të detyrës dhe masa e ndihmës, e cila është në vlerën deri në 10 (dhjetë) paga mujore, si dhe dokumentacioni që duhet të paraqitet në komisionin përkatës, i cili ngrihet me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme.

Në Kreun III, përcaktohet se Policia e Shtetit organizon ceremoninë mortore për punonjësin e policisë, që ka humbur jetën për shkak të detyrës. Shpenzimet e shërbimit të varrimit miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe përballohen nga buxheti i njësisë shpenzuese përkatëse, sipas dokumentacionit.

Në Kreun IV, përcaktohet se pjesëtarët e familjes që bashkëjetonin me punonjësin e policisë, në çastin e humbjes së jetës, për shkak të detyrës, në ditën përkujtimore të punonjësit, përfitojnë ndihmë financiare në masën e një page mujore referuese, e njësuar si pagë mujore, në çastin e dhënies së kësaj pagese.

Kjo pagë mujore referuese përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune që kishte punonjësi, e cila njësohet si pagë mujore, në çastin e dhënies së kësaj pagese.

Dhënia e ndihmës financiare do të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe do të përballohet nga buxheti i miratuar i njësive shpenzuese përkatëse në Policinë e Shtetit.

Në Kreun V, parashikohet se pjesëtarët e familjes, që bashkëjetonin me punonjësin e policisë, në çastin e humbjes së jetës për shkak të detyrës, përfitojnë pension familjar suplementar, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve,

të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në Kreun VI, përcaktohen rastet e trajtimit të fëmijëve të punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, me bursa për shkollim në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë, sipas përcaktimeve dhe procedurave për dhënien e tyre në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë.

Në Kreun VII, parashikohet që bashkëshorti/ja dhe fëmijët e punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, kur janë të pastrehë, përfitojnë falas, të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave ose Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, ose në administrim të tyre; banesa të siguruara në zbatim të projekteve të investimit të Korporatës së Investimeve Shqiptare, për të cilat me vendim të Këshillit të Ministrave, vihet në dispozicion pasuri e paluajtshme shtetërore në administrim/pronësi të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë apo entiteteve të tjera publike dhe autorizohet Korporata për shkëmbimin/kompensimin/transferimin e pjesës takuese të saj për realizimin e qëllimit / nevojës publike; të sekestruara ose me prejardhje nga pasuri të sekuestruara sipas legjislacionit për sekuestrimin e pasurive nga krimi i organizuar ose të konfiskuara nga ndërtimet pa leje ose në tejkalim të lejes së ndërtimit; të blera sipas çmimit të tregut nga Policia e Shtetit, nga buxheti i miratuar i Policisë së Shtetit. Banesa transferohet pa kundërshtpërblim dhe pronësia nuk mund të transferohet nga përfituesit sipas formave të parashikuara në Kodin Civil në periudhën që familja përfituese ka fëmijë minorene, dhe në çdo rast jo më herët se 5 vjet nga marrja në pronësi. Gjithashtu, përcaktohet procedura dhe dokumentacioni, si dhe sipërfaqja e banesës sipas Aneksit nr. 1, të projektvendimit.

Në Kreun VIII, parashikohet punësimi me prioritet në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kriteret e tjera të përcaktuara për vendin e punës të pjesëtarëve të familjes, që bashkëjetonin me punonjës të policisë, në çastin e humbjes së jetës, për shkak të detyrës.

Në Kreun IX, parashikohet se punonjësi i policisë që plagoset apo dëmtohet gjatë apo për shkak të detyrës përfiton deri në 8 (tetë) paga mujore për të dëmtuarit rëndë dhe deri në 4 (katër) paga mujore për të plagosurit dhe dëmtuarit lehtë, e

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të trajtimit ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”

cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesë për natyrë të veçantë pune, referuar pagës mujore të muajit të fundit.

Në Kreun X, parashikohet se punonjësi i Policisë së Shtetit dhe pjesëtarët e familjeve të tyre kur janë të sëmurë dhe trajtohen nga institucionet mjekësore shtetërore brenda vendit, përfitojnë shërbim mjekësor pa pagesë dhe se këtë të drejtë e përfitojnë edhe në rastet kur diagnostikimi apo mjekimi i tyre kryhet nga institucionet shëndetësore jashtë shtetit.

Në Kreun XI, parashikohet se familjes së punonjësit të policisë aktivë, me pagesë kalimtare, në pension pleqërie dhe studentë kursantë, u sigurohet pagesa suplementare për përballimin e shpenzimeve të varrimit.

Në Kreun XII, parashikohet trajtimi me ndihmë financiare i pjesëtarëve të familjes, që bashkëjetonin me punonjësin e policisë, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, për periudhën nga viti 1990 deri 31.12.1998, në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë për çdo person. Gjatë periudhës nga viti 1990 deri 31.12.1999, kanë humbur jetën për shkak të detyrës 128 punonjës policie, me pjesëtarë familje 455 vetë. Efektet financiare llogariten në vlerën 136.500 mijë lekë (455 pjesëtarë familje në çastin e ndodhjes së humbjes së jetës x 300.000 (treqindmijë) lekë).

Në kreun XIII, parashikohet që efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi sipas pikave 1 të kreut II, kreut III, pikës 1 të kreut IV, pikës 1, shkronja ç) të kreut VII dhe të pikës 1 të kreut IX, planifikohen dhe përballohen nga buxheti i miratuar për programin buxhetor “Policia e Shtetit” për vitin përkatës, kurse efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1 të kreut V, planifikohen dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për përfitimet suplementare, për familjet e punonjësve të Policisë së Shtetit, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës. Gjithashtu, parashikohet shfuqizimi i dispozitave që bien ndesh me këtë vendim.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e

Arsimit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Enti Kombëtar i Banesave, Korporata e Investimeve Shqiptare, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Projektvendimi dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Arsimit, Korporatës së Investimeve Shqiptare, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në këtë projektvendim përfitimet financiare në përgjithësi janë pothuajse të njëjta me ato që përfitohen aktualisht dhe nuk sjellin efekte financiare shtesë, në programin buxhetor të Policisë së Shtetit.

Efektet financiare sipas kreut I, pika 1, për trajtimin financiar dhe ekonomik të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit, që humbin jetën për shkak të detyrës, është propozuar që të ketë efekt deri në masën e 10 pagave mujore për familjen, nuk ka efekt shtesë pasi deri tani jepet në zbatim të Ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, ku komisioni vendos për shumën për cdo pjestar të jo më pak se 200 mijë lekë. Referuar faktit mesatarisht për këtë qellim janë shpenzuar 7,800 mijë lekë në vit. Ky është një trajtim që nuk mund të parashikohet.

Efektet financiare sipas kreut VII, pika 2, për kompesimin e qirasë së banesës, deri në përfitimin falas të banesave sociale, llogaritet në vlerën 3,050 mijë lekë

në muaj, (122 familje x 25.000 lekë (mesatare e qirasë) e cila propozohet të përballohet nga programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

Ndërsa, përfitimet sipas kreut V kanë efekte financiare dhe shpenzimet buxhetore llogariten në vlerën 5.376 mijë lekë në muaj (128 familje x 42 mijë lekë shtesa mesatare pension suplementar familjar), për trajtimin me pension suplementar familjar të familjeve të punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës. Propozohet që këto shpenzime të planifikohen dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për përfitimet suplementare, për familjet e punonjësve të Policisë së Shtetit, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës.

Efektet financiare të kreut IX, pika 1, për dhënie kompensimi punonjësi i policisë që plagoset apo dëmtohet gjatë apo për shkak të detyrës përfiton deri në 8 (tetë) paga mujore për të dëmtuarit rëndë dhe deri në 4 (katër) paga mujore për të plagosurit dhe dëmtuarit lehtë, nuk ka efekt shtesë pasi deri tani jepet në zbatim të VKM nr.552, datë 27.11.1999, ku komisioni vendos për shumën për cdo pjestar të familjes nga 100 mijë lekë për plagosje të lehta dhe 200 mijë lekë për plagosje të rënda. Referuar faktit mesatarisht për këtë qëllim janë shpenzuar 2,500 mijë lekë në vit. Ky është një trajtim që nuk mund të parashikohet. Efektet financiare të kreut XII, për dhënie ndihmë të menjëhershme financiare për pjesëtarët e familjes, që bashkëjetojnë me punonjës të policisë, në çastin e humbjes së jetës, për shkak të detyrës, për periudhën nga viti 1990 deri 31.12.1998, llogariten në vlerën 136.500 mijë lekë (455 pjesëtarë familje në çastin e ndodhjes së humbjes së jetës x 300.000 (treqindmijë) lekë. Për sa i përket efekteve financiare për banesë falas, efekti financiar varet nga numëri i punonjësve të policisë që humbin jetën dhe është i kushtëzuar me gjendjen faktike, nëse familja është e pastrehë ose jo. Ky përfitimin, në bazë të pikës 2, të nenit 111 të Ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, jepet vetëm për familjarët që janë të pastrehë.

PROPOZUESI
MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
ALBANA KOCIU